

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE
“ DoDo Group” SH.P.K

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtarete dhe Shoqerite Tregtare” dhe Ligjit Nr.9273 date 03.07.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”,me date 05.02.2025 u krijua Shoqeria Tregtare “DoDo Group” SH.P.K,me Ortaket shtetasin Denis Domi ,i datelindjes 03,01,1996 lindur ne Durres dhe banues ne Durres, identifikuar me Karte identiteti Nr.J60103051H , shtetasin Amarildo Domi i datelindjes 15.10.1996 , lindur ne Maminas,Durres dhe banues ne Tirane, i identifikuar me Karte identiteti Nr.J61015008S, e cila do te funksionoje ne baze te ketij AKT-THEMELIMI.

LLOJI DHE EMRI SHOQERISE

NENI 1

Lloji I Shoqerise Tregtare eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe emri i saj eshte “DoDo Group”SH.P.K.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Zyra Qendrore e Shoqerise Tregtare “DoDo Group”SH,P,K do te jete e emertuar Mezez,Lagja Fushe Mezez,Rruga Industriale KM 1,Qendra “Pajtoni Bussines Center”,Kati 5.

REGJIMI JURIDIK

NENI 3

Shoqeria eshte shqiptare e me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria fiton personalitetin juridik qe ne momentin qe ajo regjistrohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Marketing Online.

KOHEZGJATJA

NENI 5

Shoqeria Tregtare "DoDo Group" SH.P.K., do te kryej veprimtarine dhe aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkaku.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali Themeltar I regjistruar I Shoqerise Tregtare "DoDo Group" SH.P.K., perbehet prej 100000 (njeqindemije) leke, ne vlere nominale e 2(dy) kuota.

Ortaket kontribojne ne keto vlere:

1-Denis Domi kontribon ne vlere 50000 mije leke zoterues i 1 kuote qe perben 50% te kapitalit te shoqerise.

2-Amarildo Domi kontribon ne vlere 50000 mije leke zoterues i 1 (nje) kuote qe perben 50% te kapitalit.

Ne funksion te zgjerimit apo te t'kurrjes se veprimtarise se shoqerise mund te zmadhohet apo zvogelohet kapitali i shoqerise.

Ne rast riorganizimi te dy ose me shume shoqerive, me ane bashkimi, kapitali themeltar i shoqerise tregtare "DoDo Group" SH.P.K. do te zmadhohet ne qofte se kjo e fundit do te jete shoqeri perthithese.

ADMINISTRIMI

NENI 7

Administrator I Shoqerise I emeruar nga Asambleja e Ortakeve eshte Nazmi Domi me nje afat 5 vjet me te drejte rizgjedhje.

TE DREJTAT E SHOQERISE

NENI 8

Shoqeria ka te drejte te lidh kontrata dhe te nenshkruaj marreveshje Brenda dhe jashte vendit.

Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur.

Shoqeria perballon humbjet vetem dhe deri ne kufirin e vleres se kontributit te Kapitalit Themeltar.

VITI FINANCIAR-EKSPERTET

NENI 9

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 Dhjetor.

SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 10

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven sipas ligjit dhe nga ana tjeter jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

Ky fitim i shperndahet sipas kontributit te kapitalit te ortakeve te shoqerise.

LIKUJDIMI

NENI 11

Ne kete rast Ortaket e Shoqerise marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesën shtese "shoqeri ne likujdim e siper".

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Ortaket e Shoqerise.

Aktin e themelimit e lexova dhe e gjeta konform vullnetit tim dhe e nenshkruaj pa verejtje.

ORTAKET E SHOQERISE

DENIS DOMI

Denis Domi

AMARILDO DOMI

Amarildo Domi